

VENDIM
Nr. 929, datë 18.11.2015

**PËR MBYLLJEN E AGJENCISË SË KËRKIMIT, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
(AKTI)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbylljen e Agjencisë së Kërkimit, Teknolo-gjisë dhe Inovacionit (AKTI).
 2. Nëpunësit civilë të AKTI-së të trajtohen sipas përcaktimit të nenit 50, “Transferimi në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar. Punonjësit administrativë të trajtohen sipas dispozitave të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
 3. Asetet e luajtshme, në përdorim nga Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, kalojnë në pronësi të Kryeministrit.
 4. Vendimi nr. 903, datë 26.8.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI)”, të ndryshuar, shfuqizohet.
 5. Ngarkohen Kryeministria dhe Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 janar 2016.

KRYEMINISTRI
Edi Rama